



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.1086/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Prizren, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 19.11.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 21.11.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, ashtu që subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), i shqiptohet dënimi më gjobë në shumë prej 4100 (katërmij e njëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

## A r s y e t i m

Me datën 19.11.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me të cilën pretendon se kryetari i subjektit politik Nisma për Kosovën dega në Prizren Zafir Berisha gjat heshtjes zgjedhore me datën 18 Nëntor 2017 në ora 06:35 minuta mbas dite përmes rrjetit social facebook ka bërë thirrje për ta votuar kandidatin me numër 10 nga Vetëvendosje Mutaher Haskukën duke bërë fushatë ndaj kandidatit tjetër me fjalët “ Të nderuar miq, të dielën dilni votoni dhe ndëshkoni krimin, korrupsionin e klanin pronto duke votuar nr. 10 Mytaher Haskuka”. Parashtruesi i ankesës thekson se këto veprime bien ndesh me nenin 36.1 pika b) të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara në cilësi të provës materiale.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik LVV thekson se marveshjet politike ndërmjet LVV-së dhe Nismas nuk ka asnjë efekt juridik mbi bazën e të cilit do të mund ti shqiptohet ndonjë gjobë subjektit politik LVV për shkak të publikimit të postimit në fjalë.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 të LZP-së gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

Nga shkresat e lëndës shihet se kryetari i subjektit politik Nisma për Kosovën dega në Prizren Zafir Berisha i cili për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar të komunës së

Prizrenit ka lidhur koalicion në nivelin lokal me kandidatin e LVV-së për kryetar të komunës së Prizrenit, gjatë heshtjes zgjedhore në rrjetin e tij social facebook ka bërë fushate zgjedhore dhe ka udhëzuar që të votohet kandidati për kryetar të komunës së Prizrenit me numër 10 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje dega në Prizren, si dhe i njëjti ka përdorur fjalor denigrues, ku me këtë veprim ka shkelur Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit dhe Kandidatet e tyre duke bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Lidhur me pretendimet e subjektit politik LVV se marveshjet politike dhe koalicioni ndërmjet LVV-së dhe Nisma për Kosovën dega në Prizren nuk kanë asnjë efekt juridik mbi bazën e të cilit do të mund të shqiptohet ndonjë gjobë ndaj subjektit politik LVV, Paneli konstaton se këto pretendime nuk qëndrojnë pasi që në bazë të nenit 32 par 3, 4 dhe 5 të LZP-së subjektet politike i informojnë anëtarët, mbështetësit e tyre dhe kandidatët rreth dispozitave të këtij kodi, dhe duhet të ndermarin të gjitha hapat e nevojshme për ti parandaluar nga shkelja e këtij kodi, në të kundërtën ato mbahen përgjegjëse për shkeljen e këtij kodi. Me këtë rast Paneli konstaton se Zafir Berisha në cilësinë e përkrahësit dhe mbështetësit të kandidatit të LVV-së për kryetar të komunës së Prizrenit gjatë heshtjes zgjedhore ka bërë fushatë për kandidatin e LVV-së Mytaher Haskukën.

Andaj PZAP-i duke marrë parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se subjekti politik LVV është përgjegjëse për veprimet e tij duke shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) e LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku parashihet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohej bërja fushatë në çfarëdo mënyre.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat për rastet: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, përdorimin e fjalorit denigrues, pjesëmarrjen e subjektit politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se LVV-ja, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Kodit të mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marra subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i, mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjet e tij ka mohuar shkeljet e supozuara dhe e njëjta nuk ka ofruar prova sipas nenit 32.6 të LZP-së.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

ZL Anr.1086/2017 më datën 21.11.2017.



**Kryesuesi i Panelit**  
**Hasan Shala**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.